




BASHKIA KORÇË

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT DHE MENAXHIMIT TË
KONTRATAVE TË INFRASTRUKTURËS**

REHABILITIMI I STADIUMIT “SKËNDERBEU”, KORÇË

SPECIFIKIME TEKNIKE



Drejtori i DPPTMKI - Ark. Ndriçim Hoxha

Përgatiti - Ark. Edona Venxha

Ing. Theodhor Kosti

Ark. Dhimitër Këri

Tabela përmbledhëse

	HYRJE
	SPECIFIKIME TË PËRGJITHSHME
1	PUNIME BOJATISJE
1.1	Bojë hidroplastike
1.2	Bojë hidroplastike e cilesisë së lartë
2	INSTALIME HIDRO-SANITARE DHE NGROHJE
2.1	F.V lavaman porcelani
2.2	F.V Tub kanalizimi pvc Ø 90mm
2.3	F.V Tub kanalizimi pvc Ø 110mm
2.4	F.V. Pilete dysHEMEJE Ø 50
2.5	F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, Pn 16
2.6	F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=40, t=3.00mm, Pn10
2.7	F.V WC allafrenga importi (komplet)
3	INSTALIME PËR NDRIÇIMIN
3.1	F.V. Çelësa e priza 10A me nulifikim
3.2	F.V. Kuti derivacioni plastmasi
3.3	FV kuti suport pllaket 4 mod
4	PUNIME DYER DRITARE
4.1	FV dyer të brendshme tamburato të rimesuara
4.2	Heqje e dyerve ekzistuese
5	PUNIME HIDROIZOLIMI DHE ÇATITË
5.1	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama
5.2	Kasetë shkarkimi me llamarinë xingat
5.3	Shtresë llustër çimento 1:2 t=20mm
5.4	Ulluk shkarkimi horizontal me llamarinë xingat 33cm
5.5	Ulluk shkarkimi vertikal me llamarinë xingat Ø100
5.6	Veshje kornize me llamarinë xingat
6	PUNIME MURATURE TULLE
6.1	Ndërtim mur gipsi t=10cm me dy shtresa
7	PUNIME TAVANI DHE SUVATIME
7.1	Patinim muri allçi (stuko)
7.2	Plintuse grez h=10cm
7.3	Suva brenda mur tulle ~ 4m me krah, llaç perzier M25
8	PRISHJE
8.1	Prishje mur tulle pa pastrim
8.2	Prishje shtresa betoni
8.3	Prishje suvatim mur i brendshëm
9	PUNIME SHTRESASH
9.1	Prishje shtresash ekzistuese t=10cm
10	PUNIME SHTRESASH 2

10.1	Shtresë vetoni C16/20
11	NËNSHTRESA DHE SHTRESA NË TERRITORIN E NDËRTESAVE
11.1	Shtresë me pllaka grez porcelanato
12	PUNIME TË NDRYHSME
12.1	F.V. Lllamarinë xingat e valëzuar
13	PAJISJE JASHTË LISTE
13.1	Ene boshe bafer 800 lt
13.2	Ene zgjerimi 50 lt hidr
13.3	Rezistence 1 1/2" pa termostat 380 V 6Kw
13.4	Rezistence 3 fazore 9 kw 1 1/2"
13.5	Termostat bolieri 4 kw
13.6	Kondravalvul 1 sustë
13.7	Valvul shkarkimi 1" 8 Bar
13.8	Saraqineske hollandez 1"
13.9	Reduksion 1" 1/2- 1" zingato
13.10	Reduksion 2" ½ - 1" ½ zingato
13.11	Tape (M) 1" ½ zingato
13.12	Tape (M) 2" zingato
13.13	Termometer zhytes bolieri 0-120° C
13.14	Kaldaje elektrike 24kw
13.15	Ventil ½ x ½
13.16	Galixhan dalje poshte 1/2"
13.17	Linace hidr.
13.18	Teflon ¾ profesional
13.19	F.V. Aspirator ventilator per tualet fuqi ≥ 150 m3/h
13.20	F.V. Dërrasë interaktive
13.21	F.V. Fleksibel 40 cm
13.22	F.V. Grup dushi
13.23	F.V. panel LED 60x60 36W
13.24	F.V. Pllaka gipsi 60x60
13.25	F.V. Piletë lineare dushi 100 cm
13.26	F.V. Stola me mbështetëse për stadium
13.27	F.V. Mishelator për pisuar

HYRJE

Ky relacion teknik është hartuar në kuadër të projektit për rehabilitimin e Stadiumit "Skënderbeu" në Korçë, duke përfshirë ndërhyrje në elementët arkitektonikë dhe instalimet e objektit, me qëllim përmirësimin e funksionalitetit, sigurisë dhe kushteve të përdorimit të ambienteve. Dokumenti paraqet përshkrimin teknik të punimeve të parashikuara, specifikon karakteristikat e materialeve dhe sistemeve që do të përdoren, si dhe përcakton mënyrën e

realizimit të ndërhyrjeve në përputhje me normativat teknike të ndërtimit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Objekti është përdorur vazhdimisht ndër vite (restaurimi i fundit daton në vitin 2010-11) dhe, si rezultat i amortizimit natyror dhe mungesës së ndërhyrjeve të nevojshme, një pjesë e elementeve dhe sistemeve teknike nuk plotësojnë më standardet bashkëkohore të funksionalitetit dhe komoditetit. Aktualisht, godina nuk disponon një sistem ngrohjeje të ujit funksional, paraqet probleme të lagështisë dhe infiltrimeve të ujit, si dhe një tarracë të amortizuar me performancë të pamjaftueshme ndaj faktorëve atmosferikë. Gjithashtu, ambientet e brendshme janë të vjetruara dhe nuk ofrojnë kushtet optimale, ndërsa nevojat aktuale kërkojnë krijimin e hapësirave bashkëkohore.

Ndërhyrjet e parashikuara përfshijnë kryesisht:

- Marrjen e masave për mbrojtjen nga lagështia dhe eliminimin e infiltrimeve
- Izolimin e tarracës dhe elementëve ndihmës në largimin e ujrave atmosferikë
- Sistemimin e ambienteve të tualeteve, dusheve dhomave të zhveshjes
- Vendosjen e një sistemi të për ngrohjen e ujit
- Plotësimi me elementë të tjerë për stadiumin si stola apo postacioni i kameramanit

Qëllimi kryesor i këtij projekti është përmirësimi i cilësisë së infrastrukturës dhe krijimi i kushteve bashkëkohore për stafin dhe lojtarët, duke garantuar që ndërhyrjet të jenë të qëndrueshme, funksionale, të sigurt dhe estetikisht të harmonizuara me karakterin e objektit. Punimet do të realizohen në përputhje me normativat teknike të ndërtimit në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe duke përdorur materiale dhe sisteme të certifikuar, të cilësisë së lartë, të përshtatshme për ndërtesat publike dhe institucionet.

Ky relacion teknik shërben si dokument shpjegues dhe orientues për realizimin e punimeve të parashikuara dhe përbën një pjesë të rëndësishme të dokumentacionit teknik që shoqëron projektin e restaurimit dhe modernizimit të godinës.

SPECIFIKIME TË PËRGJITHSHME

Njësitë matëse

Në përgjithësi njësitë matëse të përdorura janë njësi metrike në mm, cm, m, m², m³, copë, ml. Pikat dhjetore janë të shkruara si “.”.

Punime të gabuara

Çdo punë, që nuk është në përputhje me këto specifikime, duhet refuzuar dhe sipërmarrësi duhet të riparojë çdo defekt më shpenzimet e veta, sipas projektit.

Zëvendësimet

Zëvendësimi i materialeve të specifikuara do të bëhet vetëm me aprovimin e Mbikqyrësit të Punimeve. Nëse materiali i propozuar për t'u zëvendësuar është i njëjtë ose më i mirë se materialet e specifikuara; ose nëse materialet e specifikuara nuk mund të sillen në sheshin e ndërtimit në kohë për të përfunduar punimet e kontratës për shkak të kushteve jashtë kontrollit të Sipërmarrësit, që kjo të merret në konsideratë, kërkesa për zëvendësimin do të shoqërohet me një dokument dëshmi të cilësisë.

Dokumenta dhe vizatimet

Sipërmarrësi do të verifikojë të gjitha dimensionet, sasisë dhe detajet të treguara në vizatimet, grafikët, ose të dhëna të tjera dhe Punëdhënësi nuk do të mbajë përgjithësi për ndonjë mangësi ose mospërputhje të gjetur në to. Mos zbulimi ose korrigjimi i gabimeve ose mospërputhjeve nuk do t'a lehtësojë Sipërmarrësin nga përgjegjësia për bërjen e llogarive të madhësive, llojeve dhe sasive të materialeve dhe pajisjeve të përfshira në punën që duhet bërë sipas Kontratës. Ai nuk do të lejohet të ketë avantazhe nga ndonjë gabim ose mospërputhje, ndërsa një udhëzim i poltë do të jepet nga Punëdhënësi nëse gabime të tilla ose mospërputhje do të zbulohen.

Fotografitë para, gjatë dhe pas procesit

Sipërmarrësi duhet të bëjë fotografi me ngjyra sipas udhëzimeve të Mbikqyrësit të Punimeve në vendet e punës për të demonstruar procesin te restaurimit përpara fillimit, procesin gjatë punës së restaurimit dhe pas përfundimit të punimeve.

Mbrojtja e punës dhe e publikut

Sipërmarrësi do të marrë masa paraprake për mbrojtjen e punëtorëve të punësuar dhe të jëtës publike rreth sheshit të ndërtimit. Masat e sigurit paraprak të ligjeve të aplikushme, kodeve të ndërtësive dhe të ndërtimit do të respektohen. Makineritë, pajisjet dhe çdo rrezik do të kqyren ose eliminohen me përputhje me masat paraprake të sigurimit.

Transporti dhe magazinimi i materialeve

Transporti i çdo materiali nga Sipërmarrësi do të bëhet me makina të përshtatëshme, të cilat kur të ngarkohen nuk shkaktojnë derdhje dhe e gjithë ngarkesa të jetë e siguruar. Ndonjë makinë që nuk plotëson këtë kërkesë ose ndonjë nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do të hiqet nga kantjeri. Të gjitha materialet që sillen nga Sipërmarrësi, duhet të stivohen ose të magazinohen në mënyrë të përshtatshme për ti mbrojtur nga rrëshqitjet, dëmtimet, thyerjet, vjedhjet dhe në dizpozicion për ti kontrolluar nga Mbikëqyrësi I Punimeve në çdo kohë.

Pastrimi përfundimtarë i zones

Në përfundim të punës, sa herë që është e aplikueshme Sipërmarrësi duhet të pastrojë dhe të heqë nga sheshi të gjitha impiantet ndërtimore, materialet që kanë tepruar, mbeturinat,

skeleritë dhe ndërtimet e përkohëshme të çdo llojit dhe të lërë sheshin e lirë dhe veprat të pastra dhe në kondita të pranueshme

Mbrojtja e godinave, rrethimeve dhe strukturave.

Gjatë kryerjes të punimeve prishëse, kontraktuesi duhet të marrë masa që të mbrojnë godinat, gardhet, muret rrethues dhe strukturat që gjenden në afërsi të objektit, ku po kryhen këto punime prishëse.

Për këtë, duhen evituar mbingarkesat nga të gjitha anët e strukturave nga grumbuj dhe materiale. Kur grumbujt dhe materialet duhen zbritur poshtë, duhet pasur kujdes që të parandalohet shpërndarja ose rënia e materialeve, ose të projektohet në mënyrë të tillë, që mos të përbëjë rrezik për njerëzit, strukturat rrethuese dhe pronat publike të çdo lloji.

Cilesia e materialeve dhe krahut të punës

Te gjitha materialet e perfshira ne punimet e do te jene ne perputhje me klauzolat perkatese te ketyre specifikimeve. Po keshtu edhe krahut i punes duhet te jete ne perputhje me specifikimet.

1. PUNIME BOJATISJE

1.1 Bojë hidroplastike

Ky zë parashikon lyerjen e ambienteve të brendshme të stadiumit si:

- Dhoma e Mjekut (lyerja e mureve të dhomës)
- Tribuna Gold A (që përfshin tavanin e hyrjes së tribunës, zyrës dhe dhomës së shtypit)
- Tribuna Gold B (tavanin e të njëjtave ambiente si në rastin e Tribunës Gold A)
- Tualeti ekzisitues në Tribunën VIP dhe ambientin e tualetit të ri të që do të ndërtohet
- Dhoma e zhveshjes së skuadrës vendase (lyerja e të gjithë mureve të dhomës së zhveshjes).
- N.H.S të Tribunës A dhe B

Përpara fillimit të punimeve, kontraktori duhet ti paraqesë për aprovim, markën dhe cilësinë e bojës, që ai mendon të përdorë. Ngjyra do të jetë e bardhë, si ambientet e tjera të brendshme. Të gjitha bojërat që do të përdoren duhet të zgjidhen nga një prodhues që ka eksperiencë në këtë fushë. Nuk lejohet përzjerja e dy llojeve të ndryshme markash boje gjatë procesit të punës. Furçat, kovat dhe enët e tjera ku mbahet boja duhet të jenë të pastra. Ato duhet të pastrohen shumë mirë përpara çdo përdorimi. Gjithashtu, duhet të pastrohen kur mbaron lyerja në çdo ditë. Personeli që do të kryejë lyerjen, duhet të jetë me eksperiencë në këtë fushë dhe duhet të zbatojë të gjitha kushtet teknike të lyerjes sipas KTZ dhe STASH. Para lyerjes duhet të bëhet mbrojtja e sipërfaqeve që nuk do të lyhen (dyer, dritare, etj.) me anë të vendosjes së letrave mbrojtëse. Lyerja bëhet me dy duar me boje në një distance kohe të nevojshme për tharje të dorës së parë. Sipërfaqja të jetë uniforme dhe pa njolla.

1.2 Bojë hidroplastike e cilësisë së lartë

Ky zë parashikon lyerjen e ambienteve të jashtme të stadiumit. Fasada kryesore e Tribunës është në gjendje të mire dhe ka nevojë për lyerje vetëm në afërsi të ullukëve vertikalë që do të zëvendësohen, për shkak të lagështirës që ka krijuar njolla në murin e fasadës. Ngjyra do të jetë e bardhë, njësoj si pjesa tjetër e fasadës. Proçesi i lyerjes së sipërfaqeve të mureve dhe tavaneve kalon nëpër tre faza si më poshtë:

- Përgatitja e sipërfaqes që do të lyhet
- Paralyerja e sipërfaqes së pastruar:
- Lyerja me bojë hidromat e sipërfaqes

2 INSTALIME HIDRO-SANITARE DHE NGROHJE

2.1 F.V. Lavaman porcelani

Tualeti i ri që do të ndërtohet në ambientet e Tribunës VIP. Materiali i lavamanit është përcaktuar si porcelan. Lavamanet duhet të sigurojnë përcjellshmëri të lartë të ujrave, rezistencë ndaj goditjeve mekanike, mbrojtje izoluese ndaj ujrave, eliminim të zhurmave gjatë punës, rezistencë ndaj korrozionit dhe agentëve kimike, lehtësi gjatë punës në to dhe mundësi të thjeshta riparimi.

Lavamanët e porcelanit dhe mbështetësja e tyre fiksohen në mur me fasheta, vida dhe tapa me fileto pa ndërprerë veshjen me pllaka të murit. Pas fiksimit të saj në mur duhet të bëhet vendosja e rubinetit mbi lavaman dhe bashkimi i lavamanit me tubat e kanalizimit të sifonit dhe tubat e shkarkimit të ujrave. Njëkohësisht lavamani duhet të pajiset edhe me piletën e tij metalike.

Permasat e lavamanit janë në varësi të llojit dhe modelit të tyre. Lavamanët vendosen në lartësi 75- 85 cm. Ky zë përfshin, përveç lavamanit, edhe grupin e rubinetit me ngjyrë të kromuar me mishelator (për ujin e ngrohtë dhe të ftohtë), fleksiblat për lidhjen e lavamanit me rrjetin e uji, sara, saraçineskat dhe kolonën e porcelanit e cila vendoset poshtë lavamanit dhe piletën.

2.2 F.V. Tub kanalizimi pvc Ø 90mm

Tualeti i ri që do të ndërtohet në ambientet e Tribunës VIP. Për lidhjen e tubave të shkarkimit me njëri-tjetrin si dhe me pajisjet sanitare apo grupet e tyre do të përdoren tubat dhe rakorderitë përkatëse me material klorur polivinili (PVC), që plotësojnë të gjitha kërkesat e cilësisë sipas standardit EN 1401 ose EN 1451 (Kërkesat për sistemet e tubacioneve plastike për shkarkimin e ujërave të ndotura).

Këto tuba dhe rakorderi (pjesë bashkuese) duhet të sigurojnë rezistencë ndaj korrozionit, rezistencë të lartë ndaj agentëve kimikë, peshë të lehtë, mundësi të thjeshta riparimi, transporti dhe instalim të thjeshtë e të shpejtë (përmes lidhjeve me guarnicion gome/me fole).

Përmasat e tyre do të jenë në funksion të sasisë llogaritëse të ujit të ndotur, llojit të pajisjeve sanitare, shpejtësisë së lëvizjes së ujit dhe diametrave të tubave përkatës. Gjatë llogaritjeve, shpejtësia e lëvizjes së ujit duhet të merret 1-2 m/sek, kurse shkalla e mbushjes do të jetë 0.5-0.8 e seksionit të tubit.

Të dhënat mbi diametrin e jashtëm, gjatësitë, presionin nominal ose klasën e ngurtësisë (SN), emrin e prodhuesit, standardin që i referohen, vitin e prodhimit, etj., duhet të jepen të stampuara në çdo tub dhe rakorderi.

Diametri i rakorderive duhet të jetë i njëjtë me diametrin e tubit të shkarkimit ku do të lidhet dhe në asnjë mënyrë më i vogël se tubi më i madh i dërgimit të ujërave të ndotura që lidhet me të. Në rastet e ndryshimit të diametrit të tubave të shkarkimit dhe të dërgimit, rakorderitë duhet t'i përshtaten secilit prej tyre.

2.3 F.V. Tub kanalizimi pvc Ø 110mm

Tualeti i ri që do të ndërtohet në ambientet e Tribunës VIP. Për lidhjen e tubave të shkarkimit me njëri-tjetrin si dhe me pajisjet sanitare apo grupet e tyre do të përdoren tubat dhe rakorderitë përkatëse me material klorur polivinili (PVC), që plotësojnë të gjitha kërkesat e cilësisë sipas standardit EN 1401 ose EN 1451 (Kërkesat për sistemet e tubacioneve plastike për shkarkimin e ujërave të ndotura).

Këto tuba dhe rakorderi (pjesë bashkuese) duhet të sigurojnë rezistencë ndaj korrozionit, rezistencë të lartë ndaj agentëve kimikë, peshë të lehtë, mundësi të thjeshta riparimi, transporti dhe instalim të thjeshtë e të shpejtë (përmes lidhjeve me guarnicion gome/me fole).

Përmasat e tyre do të jenë në funksion të sasisë llogaritëse të ujit të ndotur, llojit të pajisjeve sanitare (siç janë shkarkimet kryesore apo nyjet sanitare), shpejtësisë së lëvizjes së ujit dhe diametrave të tubave përkatës. Gjatë llogaritjeve, shpejtësia e lëvizjes së ujit duhet të merret 1-2 m/sek, kurse shkalla e mbushjes do të jetë 0.5-0.8 e seksionit të tubit.

Të dhënat mbi diametrin e jashtëm, gjatësitë, presionin nominal ose klasën e ngurtësisë (SN), emrin e prodhuesit, standardin që i referohen, vitin e prodhimit, etj., duhet të jepen të stampuara në çdo tub dhe rakorderi.

Diametri i rakorderive duhet të jetë i njëjtë me diametrin e tubit të shkarkimit ku do të lidhet dhe në asnjë mënyrë më i vogël se tubi më i madh i dërgimit të ujërave të ndotura që lidhet me të. Në rastet e ndryshimit të diametrit të tubave të shkarkimit dhe të dërgimit, rakorderitë duhet t'i përshtaten secilit prej tyre.

2.4 F.V. Pilete dyshemeje Ø 50

Tualeti i ri që do të ndërtohet në ambientet e Tribunës VIP. Per shkarkimet e ujërave të dyshemeve do të përdoren piletat RAU - PP, që plotësojnë të gjitha kërkesat e cilësive sipas standartit EN 1451 (Kërkesa për testimin dhe kualitetin të tubave). Piletat mund të jenë me material plastik, inoksi dhe bronzi. Piletat duhet të sigurojnë përcjellshmëri të lartë të ujërave, rezistencë ndaj korrozionit dhe agjentëve kimikë, mundësi të thjeshta riparimi, transporti dhe bashkimi. Piletat e shkarkimit duhet të vendosen në pjesën me të ulët të sipërfaqes ku do të mbledhen ujrat. Zakonisht ato nuk vendosen në afërsi të bashkimit të dyshemese me muret, por sa më afër mesit të dyshemese. Piletat e shkarkimit lidhen me kollonat e shkarkimit me anë të një tubi PP. Lidhja e piletave me kollonat e shkarkimit mund të bëhet me tridegese të prerë në një kënd 45 ose 60 gradë. Tubi i lidhjes duhet të jetë PVC me të njëjtat karakteristika teknike të tubave të shkarkimit të ujërave. Gjatësia e këtyre tubave është 20 - 30 cm. Diametri i tyre do të jetë në funksion të daljeve të piletës ku janë vendosur. Në rastet e ndryshimit të diametrit të piletës me atë të tubit të dërgimit do të përdoren reduksionet përkatëse.

2.5 F.V. Tuba e rakorderi ujësjellesi PPR d=20~25mm, Pn 16

Tualeti i ri që do të ndërtohet në ambientet e Tribunës VIP. Për lidhjen e tubave të ujësjellësit me njëri-tjetrin si dhe me pajisjet sanitare apo grupet e tyre do të përdoren tubat dhe rakorderitë përkatëse me material polipropilen kopolimer (PPR), që plotësojnë të gjitha kërkesat e cilësisë.

Këto tuba dhe rakorderi (pjesë bashkuese) duhet të sigurojnë rezistencë të lartë ndaj korrozionit, rezistencë ndaj agjentëve kimikë, rezistencë të lartë ndaj presionit dhe temperaturës së ujit, peshë të lehtë, mundësi të thjeshta riparimi, transporti dhe instalim të thjeshtë e të shpejtë (përmes procesit të saldimit me nxehtësi/termofuzionit).

Përmasat (diametri d=20~25mm) e tyre do të jenë në funksion të sasisë llogaritëse të ujit të pijshëm ose sanitar, llojit të pajisjeve sanitare, shpejtësisë së lëvizjes së ujit dhe presioneve të punës. Gjatë llogaritjeve të rrjetit të shpërndarjes, shpejtësia e lëvizjes së ujit duhet të merret brenda normave teknike (zakonisht 1.0-2.0 m/sek), duke garantuar që presioni i punës të jetë në përputhshmëri me klasën e presionit nominal PN 16.

Diametri dhe spesori i tyre duhet të jenë sipas të dhënave në vizatimet teknike të projektit. Të dhënat mbi diametrin e jashtëm, trashësinë, presionin nominal (PN 16), emrin e prodhuesit, standardin që i referohen, vitin e prodhimit, etj., duhet të jepen të stampuara në çdo tub dhe rakorderi.

Diametri i rakorderive duhet të jetë i njëjtë me diametrin e tubit të ujësjellësit ku do të lidhet dhe në asnjë mënyrë me i vogël se tubi i dërgimit të ujit që lidhet me të. Në rastet e ndryshimit të diametrit të tubave të rrjetit (p.sh. kalimi nga $d=25\text{mm}$ në $d=20\text{mm}$) ose lidhjes me pjesë metalike të pajisjeve sanitare, rakorderitë e PPR (reduksionet, rakordet me fileto, etj.) duhet t'i përshtaten saktësisht secilit prej tyre.

2.6 F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=40mm, Pn 16

Tualeti i ri që do të ndërtohet në ambientet e Tribunës VIP. Për lidhjen e tubave të ujësjellësit me njëri-tjetrin si dhe me pajisjet sanitare apo grupet e tyre do të përdoren tubat dhe rakorderitë përkatëse me material polipropilen kopolimer (PPR), që plotësojnë të gjitha kërkesat e cilësisë sipas standardit EN ISO 15874 (Kërkesat për sistemet e tubacioneve plastike për instalimet e ujit të ngrohtë dhe të ftohtë).

Këto tuba dhe rakorderi (pjesë bashkuese) duhet të sigurojnë rezistencë të lartë ndaj korrozionit, rezistencë ndaj agjentëve kimikë, rezistencë të lartë ndaj presionit dhe temperaturës së ujit, peshë të lehtë, mundësi të thjeshta riparimi, transporti dhe instalim të thjeshtë e të shpejtë (përmes procesit të saldimit me nxehtësi/termofuzionit).

Përmasat (diametri $d=40\text{mm}$) e tyre do të jenë në funksion të sasisë llogaritëse të ujit të pijshëm ose sanitar, llojit të pajisjeve sanitare, shpejtësisë së lëvizjes së ujit dhe presioneve të punës. Gjatë llogaritjeve të rrjetit të shpërndarjes, shpejtësia e lëvizjes së ujit duhet të merret brenda normave teknike (zakonisht $1.0\text{--}2.0\text{ m/sec}$), duke garantuar që presioni i punës të jetë në përputhshmëri me klasën e presionit nominal PN 10.

Diametri dhe spesori (trashësia e murit $t=3.00\text{mm}$) i tyre duhet të jenë sipas të dhënave në vizatimet teknike të projektit. Të dhënat mbi diametrin e jashtëm ($d=40\text{mm}$), trashësinë e murit ($t=3.00\text{mm}$), presionin nominal (PN 10), emrin e prodhuesit, standardin që i referohen, vitin e prodhimit, etj., duhet të jepen të stampuara në çdo tub dhe rakorderi.

Diametri i rakorderive duhet të jetë i njëjtë me diametrin e tubit të ujësjellësit ku do të lidhet dhe në asnjë mënyrë me i vogël se tubi i dërgimit të ujit që lidhet me të. Në rastet e ndryshimit të diametrit të tubave të rrjetit ose lidhjes me pjesë metalike të pajisjeve sanitare, rakorderitë e PPR (reduksionet, rakordet me fileto, etj.) duhet t'i përshtaten saktësisht secilit prej tyre.

2.7 F.V. WC allafrenga importi (komplet)

Tualeti i ri që do të ndërtohet në ambientet e Tribunës VIP. Në ambientet e tualetit të ri që do të ndërtohet, parashikohet vendosja e një WC-je. Ajo është me material porcelani me te dhenat e standarteve teknike. Ato janë të tipit alla frenga. WC tip alla frenga, fiksohen në dyshe me ose në mur me fasheta tunxhi, vida dhe tapa me fileto pa ndeprere veshjen me pllaka të murit. Para fiksimit të tyre duhet të bëhet bashkimi me tubat e shkarkimit të ujrave. WC-ja duhet të sigurojë përcjellshmëri të lartë të ujrave, rezistencë ndaj goditjeve mekanike, mbrojtje izoluese ndaj ujrave, rezistencë ndaj korrozionit dhe agjenteve kimike, lehtësi gjatë punës në to dhe mundësi të thjeshta riparimi. Ky zë përfshin edhe kasetën e shkarkimit, fleksiblat për lidhjen e kasetës me rrjetin e ujit dhe saraçineskën.

WC-ja lidhet me sistemin e furnizimit me ujë me anë të kasetës së shkarkimit e cila mund të instalohet direkt mbi WC ose në mur e ndarë nga WC-ja. Kjo varet nga lloji i këtyre pajisjeve. Kasetë e shkarkimit vendoset në lartësi rreth 1,5 m lart nga dysheja (rasti kur është e ndarë). Ajo mund të jetë porcelani, metalike ose plastike.

3 INSTALIME PËR NDRIÇIMIN

3.1 F.V. Çelësa e priza 10A me nulifikim

Tualeti i ri që do të ndërtohet në ambientet e Tribunës VIP. Punimi konsiston në furnizimin, transportin, montimin dhe lidhjen e çelësave dhe prizave të inkastruara për instalime të brendshme, me tension nominal 230 V AC, rrymë nominale 10 A dhe kontakt mbrojtës (tokëzim/nulifikim). Pajisjet duhet të jenë prej materiali termoplastik vetëshuarës, rezistent ndaj goditjeve mekanike dhe rrezeve UV, me shkallë mbrojtjeje minimum IP20 për ambiente të brendshme të thata. Kontaktet elektrike duhet të jenë prej materiali me përçueshmëri të lartë dhe rezistencë ndaj korrozionit. Montimi duhet të realizohet në kuti standarde të inkastruara, ndërsa lidhjet elektrike sipas skemave standarde për çelësat dhe për prizat. Punimi përfshin të gjithë aksesorët e nevojshëm, testimin e funksionimit dhe dorëzimin në gjendje të gatshme për përdorim.

3.2 F.V. Kutitë derivacioni plastmasi

Tualeti i ri që do të ndërtohet në ambientet e Tribunës VIP. Punimi konsiston në furnizimin, transportin dhe montimin e kutive të derivacionit prej materiali termoplastik vetëshuarës për realizimin e degëzimeve dhe lidhjeve të instalimeve elektrike. Kutitë duhet të jenë rezistente ndaj goditjeve mekanike, lagështisë dhe plakjes, me shkallë mbrojtjeje minimum IP55 ose sipas pozicionit të instalimit. Kapaku duhet të fiksohet me vida ose sistem mbylljeje të sigurt dhe të mundësojë akses për mirëmbajtje. Përmasat e kutive do të jenë sipas numrit dhe seksionit të kabllave të nevojshme. Punimi përfshin furnizimin me të gjithë aksesorët e montimit, hyrjet për kabllot, lidhjet elektrike sipas projektit dhe testimin e instalimit.

3.3 F.V. Kuti suport pllakë 4 mod

Tualeti i ri që do të ndërtohet në ambientet e Tribunës VIP. Punimi "F.V. Kuti suport pllakë 4 mod" konsiston në furnizimin, transportin dhe montimin e kutive mbajtëse dhe suporteve për pajisje elektrike me kapacitet 4 module, të destinuara për montim të inkastruar në mure. Kutitë duhet të jenë prej materiali termoplastik vetëshuarës, rezistent ndaj deformimeve mekanike dhe temperaturave të larta, të përshtatshme për instalimin e çelësve, prizave ose pajisjeve të tjera modulare. Suporti metalik duhet të jetë prej çeliku të galvanizuar, me qëndrueshmëri të lartë mekanike dhe mundësi fiksimit të sigurt të pllakës dekorative. Punimi përfshin furnizimin me kutinë, suportin, vidat e fiksimit, aksesoret e nevojshëm, montimin sipas projektit dhe dorëzimin në gjendje të gatshme për instalimin e pajisjeve elektrike.

4 PUNIME DYER DRITARE

4.1 F.V. dyer të brendshme tamburato të rimesuara

Tualeti i ri që do të ndërtohet në ambientet e Tribunës VIP. Furnizimi dhe vendosja e dyerve, me përmasa në varësi të madhësisë së derës, përbëhen nga material tamburatë të rimesuar. Ngjyra e dyerve në objekt do të jetë e njëjtë me ngjyrën e dyerve të tjera të ambientit rrethues. Ato janë të siguruar me elementë që shërbejnë për vendosjen dhe ankorimin në strukturat e murit, si dhe me pjesët e dala që shërbejnë për rrëshqitjen e skeletit të derës. Forma e profilit është tubolare me qëllim që të mbledhë gjithë aksesoret e saj. Profili i derës do të jetë me dimensione të tilla që do të mbulohet nga profili kryesor që do të fiksohet në mur. Të gjitha dyert duhet të jenë të pajisura me brave, çelës dhe mentesha.

4.2 Heqje e dyerve ekzistuese

Heqje e derës së Zyrës së Presidentit e cila do të rivendoset në murin e ri që do të ndërtohet, që realizohet, duhet të përfshijë kasën, telajot, etj., sistemimin e materialit që ekziston brenda ambientit të kantierit dhe grumbullimin në një vend të caktuar në kantier. Çmontimi duhet të bëhet me kujdes për të mos dëmtuar muraturën. Vendosja e derës do të bëhet sipas nivelimit dhe drejtimit korrekt. Fiksimit mekanik në strukturë me elementë të përshtatshëm. Mbushja e hapësirave ndërmjet kornizës dhe murit me shkumë poliuretani. Pastrim i zonës së punimeve dhe dorëzim në gjendje funksionale.

5 PUNIME HIDROIZOLIMI DHE ÇATITË

5.1 Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama

Ky zë përfshin hidroizolimin e pjesës qendrore të tarracës (e specifikuar në vizatimet) e cila për momentin nuk ka asnjë lloj hidroizolimi, si dhe të disa pjesëve të tjera të tarracës ku hidroizolimi ka pësuar dëmtime. Parashikon aplikimin e një sistemi hidroizolues të përbërë nga një shtresë paraprake me emulsion bituminoz (primer) dhe dy shtresa membranë

bituminoze (2 k katrama), për mbrojtjen e sipërfaqeve horizontale ose të pjerrëta nga depërtimi i ujit dhe lagështirës. Sipërfaqja mbi të cilën do të aplikohet hidroizolimi duhet të jetë e pastër, e thatë, e rrafshët dhe pa papastërti, pluhur apo materiale të lirshme. Pas aplikimit të emulsionit bituminoz si shtresë aderuese, vendosen dy shtresa membranë bituminoze me trashësi minimale 4 mm secila, të armuara me fibër poliesteri ose fibër qelqi, të salduara me flakë, me mbivendosje minimale 12 cm në nyjet gjatësore dhe 15 cm në nyjet fundore, duke siguruar vazhdimësi dhe papërshkueshmëri të plotë. Punimi përfshin trajtimin e qosheve, ngritjeve vertikale, bashkimeve dhe të gjitha detajeve konstruktive, kontrollin e cilësisë së saldimeve dhe dorëzimin e sistemit hidroizolues të përfunduar, plotësisht funksional dhe në përputhje me standardet teknike në fuqi.



Figure 1 - Pamje e tarracës pa izolim

5.2 Kasetë shkarkimi me llamarinë xingat

Janë për mbledhjen dhe shkarkimin e ujërave të shiut nga çatitë dhe tarracat drejt sistemit të drenazhimit. Kasetat e shkarkimit realizohen me llamarinë të xingatosur me trashësi të caktuar, me dimensione standarde për të përballuar prirjen e ujërave nga sipërfaqet përkatëse. Kasetat duhet të montohen fort në pikat e shkarkimit të çatisë ose tarracës, me anë të mbajtëseve dhe aksesoreve fiksues të xingatosur, të cilët mbrojnë materialin nga korrozioni. Lidhjet e llamarinës duhet të jenë plotësisht të hermetizuara për të parandaluar rrjedhjen e ujit. Pjesa e poshtme e kasetës duhet të lidhet në mënyrë të sigurt me ullkun vertikal të shkarkimit, duke garantuar shkarkim të rrjedhshëm dhe pa pengesa.

5.3 Shtresë llustër çimento 1:2 t=20mm

Ky zë përfshin hidroizolin e pjesës qendrore të tarracës (e specifikuar në vizatimet) e cila për momentin nuk ka asnjë lloj hidroizolimi. Përgatitjen dhe aplikimin e një shtrese llustre çimentoje me trashësi 20 mm mbi sipërfaqen e tarracës, e cila shërben si shtresë mbrojtëse dhe niveluese mbi sistemin hidroizolues, duke siguruar një bazë të fortë, të rrafshët dhe të qëndrueshme për shtresat përfundimtare të dyshemesë ose për ekspozimin e drejtpërdrejtë ndaj kushteve atmosferike, sipas projektit.

Llaçi do të përgatitet me raport 1:2 (çimento - rërë), duke përdorur çimento sipas standardeve në fuqi dhe rërë të larë, me granulometri të përshtatshme, pa përmbajtje argjile, lëndësh organike ose papastërtish të tjera që mund të ndikojnë në rezistencën dhe cilësinë e shtresës. Uji i përdorur për përgatitjen e llaçit duhet të jetë i pastër dhe i përshtatshëm për punime ndërtimore.

Përpara aplikimit të llustrës, sipërfaqja e hidroizolimit duhet të jetë e pastër, e thatë dhe pa dëmtime. Llustra do të aplikohet në mënyrë uniforme me trashësi 20 mm, duke respektuar pjerrësitë e projektuara për largimin e ujërave të shiut drejt pikave të kullimit. Pjerrësia duhet të jetë e vazhdueshme dhe pa kundërpjerrësi që mund të shkaktojnë grumbullim të ujit në sipërfaqen e tarracës.

Sipërfaqja do të nivelohet dhe do të përfundohet me finiturë të lëmuar duke eliminuar zgavrat, plasaritjet dhe parregullsitë. Në sipërfaqe me dimensione të mëdha duhet të realizohen fuga tkurrije dhe dilatimi, për të reduktuar rrezikun e plasaritjeve si pasojë e ndryshimeve termike dhe tkurries së materialit.

Gjatë periudhës së pjekjes, shtresa e llustrës duhet të mbrohet nga tharja e menjëhershme, rrezatimi i fortë diellor, reshjet dhe temperaturat e ulëta. Sipërfaqja duhet të mbahet e lagësht për disa ditë pas aplikimit, sipas praktikave teknike, në mënyrë që të sigurohet zhvillimi normal i rezistencës mekanike dhe të shmanget formimi i plasaritjeve sipërfaqësore.

5.4 Ulluk shkarkimi horizontal me llamarinë xingat 33cm

Zëvendësimi i ullukëve pranë hyrjes së Tribunës Gold A dhe Gold B. Ullukët janë prej material PVC, por rezultojnë të thyer dhe ose çarë, për këtë arsye kërkohet zëvendësimi i tyre me ullukë llamerine që mund ti rezistojë më mire goditjeve ose përdorimit. Pozicioni i tyre është i treguar në vizatime dhe në foton e mëposhtme. Realizohen me pjerrësi prej 1% për largimin e ujrave. Ulluqet horizontale prodhohen me llamarinë bakër. Ulluku me llamarinë me trashësi jo më të vogël se 0,8 mm, i formuar nga pjesë të modeluara me mbivendosje minimale 5 cm, të salduara në mënyrë të rregullt me kallaj, me bord të jashtëm 2 cm më të ulët se bordi i brendshëm, të kompletuara me pjesë speciale për grykën e hyrjes. Ulluku horizontal, i modeluar sipas udhëzimeve në projekt, duhet të jetë i lidhur me tel xingato me hallka të forta të vëna maksimumi në 70 cm. Janë për shkarkimin e ujrave të çative dhe kur janë në gjendje jo të mirë duhet të çmontohen dhe të zëvendësohen me ullukë të rinj.

5.5 Ulluk shkarkimi vertikal me llamarinë xingat ø100

Zëvendësimi i ullukëve pranë hyrjes së Tribunës Gold A dhe Gold B. Ullukët janë prej material PVC, por rezultojnë të thyer dhe ose çarë, për këtë arsye kërkohet zëvendësimi i tyre me ullukë llamerine që mund ti rezistojë më mire goditjeve ose përdorimit. Pozicioni i tyre është i treguar në vizatime dhe në foton e mëposhtme. Ulluqet vertikale për shkarkimin e ujrave të çative që përgatiten me llamarinë bakër, duhet të kenë trashësi jo më të vogël se 0.6 mm dhe diametër 10 cm dhe mbulojnë një sipërfaqe nga 30 deri në 60 m². Ullukët duhet të vendosen

në pjesën e jashtme të ndërtesës, me anë të qaforeve përkatëse, të fiksuar çdo 2 m. Ujrat e tarracës që do të kalojnë në tubat vertikale duhet të mbliidhen nëpërmjet një pjate prej llamarine, i riveshur me guainë të vendosur në flakë, me trashësi 3 mm, të vendosur në mënyrë të tërthortë, ndërmjet muraturës dhe parapetit. Pjesa fundore e ulluqeve, për lartësinë 2 m, duhet të jetë e mbërthyer fort me ganxha hekuri si dhe poshtë duhet të kthehet me bërthyl 90 gradë.



Figure 2 - Vendndodhja e ullukëve që do të zëvendësohen

5.6 Veshje kornize me llamarinë xingat

Veshja e perimetrit të tarracës, me llamarinë të xingatuar (impjuve) do të realizohet me qëllim mbrojtjen e strehës nga agjentët atmosferikë dhe parandalimin e infiltrimeve të ujit. Fillimisht do të kryhet pastrimi dhe përgatitja e sipërfaqes, duke eliminuar papastërtitë. Më pas, llamarina e xingatuar do të pritët dhe formohet sipas përmasave, duke u fiksuar mekanikisht me vida inox ose të galvanizuara. Nyjet, mbivendosjet dhe pikat e kontaktit me muraturën ose elementet e tjera do të mbyllën me mastikë ose silikon hidroizolues rezistent ndaj kushteve atmosferike, duke garantuar një veshje të qëndrueshme, funksionale dhe afatgjatë. Impluvet do të jenë material llamarinë zingato 0.8mm të trashë dhe do të kapen në murin vertikal rreth 20cm dhe do të zgjaten horizontalisht rreth 25-30cm. Impjuvet janë prezent në tarracë, dhe shumica e tyre është në gjendje të mirë, por disa elementë janë shkëputur ose dëmtuar nga agjentët atmosferikë dhe për këtë arsye do të bëhet zëvendësimi i elementëve.